



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

NJOFTIM

PËR PROCESIN E REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR AUDITUES TË BRENDSHËM  
NË SEKTORIN PUBLIK, SEZONI 2020-2021

Në mbështetje të Urdhërit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 65, datë 06.03.2020 “Për fillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2020-2021”, të ndryshuar, Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (DHAB) njofton se, të gjithë kandidatët për auditues të brendshëm që janë shpallur fitues në listën përfundimtare për të ndjekur procesin e certifikimit në sezonin 2020-2021, kanë detyrimin të paguajnë tarifën e regjistrimit prej 40.000 (dyzetëmijë) lekë sipas përcaktimit në VKM-në Nr.116, datë 17.02.2016 “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”, kreu IV, pika 1, gërma (a).

Tarifa derdhet në llogarinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Të ardhura” në çdo degë banke të nivelit të dytë dhe është e pakthyeshme.

Të gjithë kandidatet e shpallur fitues në listën e publikuar, duhet të depozitojnë pranë DHAB-së, një kopje të mandatit të pagesës, jo më vonë se data **11.12.2020**.

Faturën për arkëtim të tarifës së regjistrimit e gjeni dhe shkarkoni nga faqja e internetit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me adresë: [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al).

Në rast se kandidati nuk kryhen pagesën e tarifës së regjistrimit, atëherë ç’regjistrohet menjëherë nga procesi i certifikimit.

Për informacione të mëtejshme mund të vizitoni faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me adresë: [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al), si dhe mund të kontaktoni me stafin e DHAB-së.